



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

E - buletini no.15

Janar 2018

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Aksioni për Zhvillim Rural (AZR) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret parasysh për të pasqyruar mendimet e Bashkimit Evropian



Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Banorëve Rural

'Kosta Veselinov' 3a,
1000 Skopje
R. Macedonia
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk
zg.akrra@yahoo.com

Organizatrat e implementimit





Bashkë deri në politika më të mira për zhvillim rural

Fondacioni për Lidhje me Vlera Natyrore dhe Njerëz (CNVP), Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM) dhe Aksioni për Zhvillim Rural (AkRRa), si zbatues të projektit “Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale – PKR”, i financuar nga BE, në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillimin e Rajoneve të Planifikimit të Shkupit, më 13 korrik 2017 ka zhvilluar takim të fundit prej 8 takimeve me sektorin qytetar, të organizuar në gjithë rajonet e planifikimit të R. së Maqedonisë.

Ky takim, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave qytetare të rajonit të Shkupit ka pasur për qëllim identifikimin e organizatave qytetare që punojnë në fushën e zhvillimit rural, shkëmbim të përvojave dhe informim për

mundësitë e kyçjes më të madhe në krijimin e politikave për zhvillim rural.

Projekti “Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale – PKR”, është dizajnuar për të përforcuar ndikimin e shoqërisë qytetare mbi politikat kombëtare dhe lokale lid-

hur me zhvillimin rural. Kjo do të arrihet me anë të rritjes së kapacitetit të organizatave rurale për rrjetëzim dhe përfaqësim me qëllim të ndikimit në proceset e miratimit të vendimeve dhe të kontribuojnë në partneritetin strategjik me autoritetet lokale dhe kombëtare.





Rrjetëzimi rajonal dhe ndarja e praktikave më të mira në fushën e politikave për zhvillim rural

Më 24 nëntor 2017, në hotelin “Bushi” në Shkup, ekipi i projektit “Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale” ka organizuar një punëtori të dedikuar **“Rrjetëzimi rajonal dhe ndarja e praktikave më të mira në fushën e politikave për zhvillim rural”**.

Qëllimi i punëtorisë ishte të niset një dialog mes sektorit qytetar të viseve rurale dhe krijuesit të politikave në nivel kombëtar për të siguruar pjesëmarrje të shoqërisë qytetare në proceset e marrjes së vendimeve. Punëtorija ka prezantuar perspektiva zhvillimore për vendin dhe rajonin të cilat janë me interes të përbashkët për krijuesit e politikave dhe përdoruesit e atyre politikave. Përvojat e ndara nga përfaqësues të organizatave nga Serbia, Shqipëria, Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina, të cilët punojnë në fushën e zhvillimit rural, kanë siguruar mundësi për rrjetëzim dhe ndarje të praktikave me të mira në fushën e politikave për zhvillim rural në rajon.

Prezantimi i përgatitur nga përfaqësues i MPBEU, Valentina Stojanoviç-Tufa, ka dhënë një pasqyrë të përpjekjeve të bëra për përmirësimin e dialogut mes krijuesve të politikave për bujqësi dhe zhvillim rural dhe sektorin qytetar. Ky prezantim ka nisur një panel diskutim



për mënyrat e përmirësimit të politikave për zhvillim të qëndrueshëm në fushat rurale me anë të bashkëpunimit të autoriteteve kombëtare me sektorin qytetar.

Panelistët më poshtë kanë ndarë përvojat nga vendet e tyre në kontekste të ndryshme:

- Trajan Dimkovski – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit të RM;

- Maja Markovska – Milieukontakt Maqedoni;
- Dragan Roganoviç – Rrjeti Rural i Serbisë;
- Julia Bakota – Rrjeti Rural i Kroacisë.

Panel diskutimi ju ka mundësuar shumë palëve dhe organizatave qytetare të përhapin njohurinë e tyre për rrjetëzimin dhe mënyrat potenciale për përmirësimin e dia-





logut mes krijuesit e politikave për zhvillim rural dhe sektorin qytetar. Me qëllim të kuptimit më të lehtë të gjendjes aktuale të mjediseve rurale në Ballkanin Perëndimor, panelistët kanë ndarë përvoja lidhur me dialogun mes sektorit qytetar dhe krijuesit e politikave për zhvillim rural, duke theksuar disa prej pengesave që paraqiten në këtë proces. Në fund, ata kanë shtuar rekomandime të tyre për përmirësimin e dialogut mes krijuesve të politikave për bujqësi dhe zhvillim rural dhe sektorin qytetar.

Pas panel diskutimit, kanë vijuar shembuj pozitiv të rolit të sektorit qytetar dhe pjesëmarrja e tyre në zbatimin e aktiviteteve për zhvillim të qëndrueshëm në mjediset rurale.

- Vasko Haxhievski ka ndarë rezultatet e hulumtimit të zbatuar në kuadër të projektit “Komiteti kombëtar për bujqësi familjare në Republikën e Maqedonisë” që ka pasur për qëllim të përcaktojë gjendjen e ekonomizimit të bujqësisë familjare në Maqedoni dhe roli përkatës në zhvillimin rural.

- Përfaqësuesi i Rrjetit për Zhvillim Rural të Shqipërisë, Albana Hasmeta, në sajë të temës “Zhvillimi ekonomik i grave në mjediset rurale” ka prezantuar gjendjen aktuale të gruas shqiptare në lidhje me arsimin dhe pozitën në tregun e punës, ka ndarë shembuj të praktikave të mira dhe ka prezantuar sfidat që shtrihen përpara në procesin e përmirësimit të pozitës ekonomike të gruas rurale.

- Dushko Vcetinoviq, kryetar i shoqatës së qytetarëve “Nesto Vise” nga Bosnja dhe Hercegovina, i prezantoi rezultatet nga tre projektet të synuar për të rinjtë në mjediset rurale. Me anë të programit për bursë në BiH janë dhënë 85 bursa për studentë që në vit kanë realizuar 500 orë pune në dobi të komunitetit. Projekti “Punëso me anë të vullnetarizmit – bëj vullnetarë për t’u punësuar” në vitin 2010 ka punuar në promovimin e vullnetarizmit dhe institucionalizimin e kësaj dukurie. Projekti “Shkathtësi jete për të ardhmen – Ejani të mësojmë, ejani të bëjmë!” ka kontribuar për

zhvillimin e shkathtësive sipërmarrëse tek nxënësit e klasës 7, 8 dhe 9 dhe përgatitjen e tyre për konkurrencë më të madhe në tregun e punës.

- “Rrjetëzimi rajonal dhe shkëmbimi i praktikave të mira në fushën e politikave për zhvillim” ishte tema në të cilën u fokusua kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, Petar Gjorgievski. Në prezantimin e tij, ai theksoi rëndësinë e rrjetëzimit në procesin e përhapjes së inovacioneve dhe praktikave të mira, lidhje të aktorëve rural, stimulim të projekteve për bashkëpunim dhe tejkallim të izolimit me të cilën përballohen disa rajone rurale. Më tutje, i njoftoi të pranishmit me llojet e rrjeteve siç janë: rrjetet institucionale nga të financuar nga Komisioni Evropian dhe rrjetet joformale në nivel evropian, kombëtar, rajonal dhe lokal, që nuk janë të financuar nga Komisioni Evropian. Si model për rrjetëzim rajonal, ka prezantuar Rrjetin Ballkanik për Zhvillim Rural që bashkon rrjetet për zhvillim rural të Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Shqipëri dhe Kosovë.
- Dragan Roganoviq, kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural të Serbisë, në fushën e turizmit rural, ka mbajtur vëmendjen e të pranishmëve me prezantimin e tij interesant për projektin e zhvillimit të turizmit rural në fshatin Rudno dhe parkun kombëtar “Golija”. Projekti zbaton një sërë aktivitete në 5 komuna që përfshijnë parkun kombëtar “Golija”, mes të cilëve: zhvillimi i pilot qendrave për mbrojtje, zhvillim dhe promovim; përmirësimi i kapaciteteve





të popullatës lokale për zhvillim të turizmit rural; mbështetje e 5 komunave për bashkëpunim të ndërsjellë për zhvillimin e turizmit rural dhe përmirësimi i infrastrukturës turistike (shënimi i rrugëve për shëtitje në mal dhe ciklizëm, etj.).

Prezantimet kanë nxitur diskutim mes të pranishmëve dhe ishin sjellë konkluzionet më poshtë:

- Rritje të përfshirjes së banorëve lokal/aktorëve në përgatitjen e strategjive dhe programeve është me rëndësi thelbësore, sepse kjo është mënyra e vetme që të funksionojnë masat për zhvillim rural.
- Mekanizmat dhe veglat e zhvilluara nga organizata të ndryshme joqeveritare mund të lehtësojnë krijimin e strategjive dhe politikave në nivel lokal, andaj duhet të merren parasysh në mënyrë më serioze.
- Kur dizajnohen politikat, me rëndësi është të vendoset mekanizëm për kthim të informacioneve nga niveli lokal në nivelin kombëtar. Kjo është me rëndësi që të kontrollohet nëse politikat dhe masat janë të zbatueshme dhe a zbatohen me lehtësi.
- Efikasiteti i administratës shtetërore duhet të përmirësohet, por edhe popullata lokale, duhet të kuptojë që nëse respektohen qasjet pjesëmarrëse, ato marrin shumë kohë.
- Shoqëria qytetare, veçanërisht personat që jetojnë në viset rurale, duhet vazhdimisht të ngritin kapacitetet për të qenë të përgatitur për pjesëmarrje aktive në përgatitjen e strategjive dhe



programeve në nivel lokal ose kombëtar.

Më tepër se 60 përfaqësues të organizatave aktive qytetare rurale nga Maqedonia kanë marrë pjesë në punëtorinë rurale në të cilën ishin informuar nga ana e partnerëve në projektin për mundësinë që të jenë drejtpërdrejtë të kyçur si për-

dorues të zbatimit të aktiviteteve projektuese për vitin 2018. Projekti, që zbatojnë CNVP – Organizata për Lidhen e Vlerave Natyrore dhe Njerëzit, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë dhe AkRRa – Aksioni për Zhvillim Rural” është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.



Regjistri i organizatave aktive qytetare për zhvillim rural

Projekti “Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale”, financuar nga Bashkimi Evropian, gjatë gushtit dhe shtatorit, ka zbatuar një hulumtim në teren në 8 rajonet e planifikimit të Republikës së Maqedonisë, me qëllim të identifikimit organizatave aktive që punojnë në fushën e zhvillimit rural. Si rezultat i këtij aktiviteti ishte krijuar një Regjistër i organizatave aktive qytetare rurale me të cilën do të mundësohet mobilizim më i lehtë i organizatave qytetare në zgjidhjen e çështjeve/temave të caktuara për të cilat do të diskutohet në shoqëri dhe do të përforcohet komunikimi i ndërsjellë dhe shembim i informacioneve. Regjistri do të shërbejë institucioneve kombëtare për mapimin më të lehtë, të kontaktimit ose të angazhimit të organizatave relevante në proceset e vendimmarrjes ose fushatave për ngritjen e vetëdijes. Regjistri është i gatshëm në ueb faqen e Rrjetit për Zhvillim Rural, në lidhjen vijuese: <http://ruralnet.mk/.../REGISTAR-NA-AKTIVNI-GRAGJANSKI-ORGANIZ...>

Regjistri, si burim i hapur i informacioneve i gatshëm për të gjithë, do të përditësohet dhe plotësohet gjithë kohën me të dhëna për organizata të reja që në mënyrë aktive punojnë në fushën e zhvillimit rural. Andaj, nëse jeni organizatë qytetare që punon në fushën e zhvillimit rural, dhe që nuk gjendeni në këtë regjistër, partnerët e projektit ju inkurajojnë që të plotësoni pyetësorin më poshtë <http://ruralnet.mk/.../Form-for-registration-of-CSOs-template...> dhe të dorëzoni në zg.akrra@yahoo.com me çfarë do të kontribuoni që të përmirësohet dhe zmadhohet baza me të dhëna.

Qëllimi kryesor i decentralizimit është të kyç popullin në procesin e vendimmarrjes. Ajo do të mundësojë qytetarëve një pjesëmarrje aktive në gjetjen e zgjidhjeve për problemet e përditshme në qytetet dhe fshatrat e tyre. Institucionet lokale dhe kombëtare në vend janë munduar të përfshijnë palët e interesuara në procesin e përgatitjes së strategjive për bujqësi dhe zhvillim rural. Fokusi kryesor ishte vendosur mbi informimin dhe konsultimin, me anë të seminareve dhe debateve. Ndonëse ishin vendosur disa baza për lëvizje të më-



tutjeshme për pjesëmarrje më të madhe, një numër i madh i organizatave qytetare nuk mund të lidhen me proceset e krijimit të politikave. Në këtë drejtim, projekti “Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale” punon në përfaqësimin, rrjetëzimin dhe ndërtimin e kapaciteteve, për të mundësuar më tepër aktorëve të lidhen me këto procese. Projekti i mbështet organizatat qytetare rurale që të shprehin zërin e tyre dhe të zmadhojnë praninë e tyre në proceset e zhvillimit të komunitetit.. mobilizimi i gjithë aktorëve relevant të cilët në mënyrë të drejtë ose jo ndikojnë në sektorin bujqësor dhe rural, është veçanërisht me rëndësi për formimin e një përgjigjeje efektive dhe mirë të koordinuar bujqësor dhe rural i institucioneve të shtetit gjatë krijimit të politikës bujqësore, përshtatjes së rregullores ligjore dhe reformave në institucionet publike.





PARLAMENTI EVROPIAN RURAL 2017

Rreth 250 përfaqësues të komuniteteve rurale në 40 vende evropiane, mes të cilëve edhe Republika e Maqedonisë, janë takuar në Parlamentin e Tretë Rural, që u zhvillua në fshatin Venhorst, provinca e Brabantit Verior, Holandë, prej 18 deri më 21 tetor 2017, nën patronazhin e Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të institucioneve të Bashkimit Evropian, të disa qeverive kombëtare dhe organizatave qytetare të shumë vendeve.

Pjesëmarrësit, në Deklaratën nga Venhorst, kanë thirrur për një epokë të re të zhvillimit lokal sipas parimit “nga poshtë-lartë”, e bazuar në aktivitete të komuniteteve rurale. Kjo është inspiruar nga numri i shpejtë i rritur i iniciativave lokale në qytetet dhe fshatrat dhe nga nevoja për përforcimin e gjallërisë së rajoneve rurale nëpër gjithë Evropën.

Më tepër propozim për Fond të ri Evropian për zhvillim lokal i udhëhequr nga komuniteti ishin nisur nga ana e parlamentit të tretë rural evropian, që u mbledh në kuptimin simbolik në fshatin Venhorst, Holandë. Tani kur institucionet evropiane formulojnë të ardhmen e programeve dhe fondeve të Be-së, Parlamenti Evropian Rural ka thirrur për një bazë të re të unifikuar i financimit të zhvillimit lokal. Kjo do të bashkojë një pjesë të madhe të katër fondeve evropiane – rural, rajonal, social dhe bregdetar – në një fond për zhvillim lokal të udhëhequr nga komuniteti, i drejtuar në mënyrë të unifikuar të gjitha niveleve evropiane dhe kombëtare.

Këto mjete të kombinuara më vonë duhet të shpërndahen në nivel të decentralizuar me anë të LEADER grupeve dhe partneriteteve tjera lokale. Ajo do të gjenerojë energjinë e personave rural dhe organizatave që punojnë bashkë, do të nxit



aksion të përshtatur për shumë nevoja të ndryshme për çdo vend.

Gjithashtu, Deklarata do të përqendrohet në çështje tjera aktuale kryesore në Evropën rurale. Pjesëmarrësit në “Venhorst” e kanë përsëndetur zhvillimin e suksesshëm të Parlamentit të Parë Evropian të Rinisë Rurale në gusht 2017 dhe kanë thirrur që autoritetet publike të sigurojnë të rinjve të marrin pjesë në programet e financuar. Ata ishin të nxitur nga veprimi më i gjerë i komuniteteve rurale në pritjen e refugjatëve dhe migrantëve ekonomik dhe në përbalimin me varfërinë dhe përjashtimin social. Ata kanë thirrur në një aksion imagjinar për mirëmbajtjen e shërbimeve rurale dhe për diversifikimin e ekonomive rurale.





Ulje e prekshmërisë së bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike

Ndryshimet klimatike që kanë ndikim negativ në nivel mikro dhe makro në planetin, paraqesin një problem serioz me pasoja afatgjata. Këto ndryshime paraqesin një rrezik potencial për gjitha fushat e ekzistencës së njeriut. Fillon seriozisht të vihet në pikëpyetje plotësimi i nevojave për ushqim dhe ujë në nivelin global, por me efekte shumë më negative në disa rajone të caktuara të planetit. Megjithatë, efekt më të madh ndryshimet klimatike kanë mbi bujqësinë, që paraqet një sfidë serioze për fermerët.

Rritja e numrit të ditëve të ekspozimit të kafshëve në ambient me temperaturë të lartë dhe lagështi të ajrit, shkakton paraqitjen e stresit nga ngrohja. Stresi nga ngrohja përveç që ndikon drejtpërdrejtë mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore të kafshës, shkakton edhe prishje serioze të performancave riproduktive dhe produktive të kafshëve. Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë mbi kafshët, temperaturat e larta dhe lagështia e ajrit kanë ndikim të madh mbi paraqitjen dhe shpërndarjen e shumë sëmundjeve ngjithëse, kryesisht për shkak të krijimit të kushteve për

zhvillim të vektorëve- përçuesve të sëmundjeve dhe dëmtuesve të ndryshëm. Në këtë mënyrë, përveç mirëqenies së prishur të kafshëve, reproduksioni i prishur dhe zvogëlimi i prodhimit të kafshëve përkatëse, zvogëlohet edhe rentabiliteti i prodhimtarisë. Ky është një moment i rëndësishëm në motivacionin dhe momenti social tek blegtorët.

Me qëllim të përballimit me kohë të sfidave nga ndryshimet klimatike dhe zvogëlimin të pasojave të dëmshme, duhet një edukim i vazhdueshëm i blegtorëve, si dhe të nxënësve të shkollave të mesme bujqësore në lidhje me ndikimet aktuale por edhe të ardhshme të pritura të ndryshimeve klimatike mbi organizimin e kafshëve dhe zgjidhjet e mundshme për tejkalimin e tyre. Në këtë drejtim, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, si zbatues i projektit për bashkëpunim teknik të FAO: "Zvogëlimi i prekshmërisë së bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike" në Republikën e Maqedonisë, ka punuar në ngritjen e kapaciteteve të fermerëve, organizatave bujqësore dhe këshilltarëve të ANZHB-së për zgjidhjen e shumë çështjeve lidhur me ndryshimet



klimatike. Aktivitetet e parashikuara të projektit që kanë filluar në mars 2017 dhe kanë mbaruar në fund të vitit, kanë pasur për qëllim të ngritin kapacitetin e subjekteve në Republikën e Maqedonisë për transmetimin e njohurisë për ndryshimet klimatike. Në fund, aktivitetet duhet të nxisin transmetime relevante ndaj sistemeve të adaptuara dhe elastike të prodhimtarisë.

Pakoja e aktiviteteve ka përfshirë dy grupe synuese kryesore:

- shkollat e mesme bujqësore në RM – aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të shkollave të mesme bujqësore dhe prezantimi i ndryshimeve klimatike në programet arsimore;
- këshilltarë të ANZHB – aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të këshilltarëve të ANZHB-së për dhënien e këshillave për fermerët mbi përballimin me ndryshimet klimatike.

Për të promovuar rezultatet e aktiviteteve të zbatuara, Rrjeti për Zhvillim Rural ka organizuar ngjarje përfundimtare që u zhvillua më 15 dhe 16 nëntor 2017 në Shkup.





Aktivitetet e Projektit ALTER

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë si partner i projektit "ALTER" – Territore Lokale Aktive për Zhvillim Ekonomik i Rajoneve Rurale", gjatë periudhës korrik-dhjetor 2017 ka organizuar shumë aktivitete në nivelin kombëtar, me synim të përforcimit të kapaciteteve të OJQ-ve dhe rrjeteve të OJQ-ve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në planifikimin e politikave dhe zbatimin, si dhe për të krijuar partnëritete me institucionet publike.

Në këtë drejtim, ishte organizuar një trajnim treditör për ngritjen e kapaciteteve në Pehçevë, si dhe 6 takime njëditëshe për të mbështetur rrjetin aktuale për zhvillim rural dhe për të lehtësuar zhvillimin e planeve strategjike organizative afatgjate dhe planeve për ngritjen e fondeve. Për afirmim më të madh të qasjes EU LEADER dhe ngritjes së vetëdijes të medieve lokale,



ishte organizuar një trajnim në Strumicë, më 31 tetor dhe 1 nëntor, duke mbledhur 11 përfaqësues të medieve dhe 6 përfaqësues të OJQ-ve. Qasja LEADER ishte promovuar edhe në mesin e aktorëve rural me anë të punëtorive të organizuar në Gjevgjeli dhe Vinicë. Dy

punëtori kombëtare dhe një punëtori lokal janë planifikuar për vitin e ardhshëm, për të rritur njohurinë e aktorëve rural për parimet e qasjes LEADER dhe të motivohen për të marrë pjesëmarrje aktive dhe mbështetje për krijimin e Grupeve Lokale të Aksionit.



Ky projekt katërvjeçar, duke filluar nga dhjetori 2015, është zbatuar nga 9 partnerë nga Ballkani dhe Turqia dhe dy vende nga BE-ja: Rrjeti për Zhvillim Rural i BiH, Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural i Kosovës, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Malit të Zi, Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (Shqipëri), Fondacioni për Zhvillim i Turqisë, Forumi Rural i Letonisë, Rrjeti Kroat për Zhvillim Rural.





Përfundimi i BRDN strategjisë dhe planit të veprimit

Përfaqësuesit e rrjeteve të zhvillimit rural të Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë janë mbledhur në Ohër më 22 nëntor për të përfunduar strategjinë 5 vjeçare të Rrjetit për Zhvillim Rural të Ballkanit dhe planin e veprimit 2 vjeçar. Në fillim të punëtorisë, përfaqësuesi i We Effect, si donator i projektit dhe përfaqësuesit e SWG (Grupi i Përherëshëm i Punës për Zhvillim Rajonal Rural në Evropën Juglindore) ka prezantuar pjesëmarrësit me strukturën organizative dhe aktivitetet. Pas shqyrtimit të BRDN vizionit dhe misionit dhe diskutimi mbi prioritetet strategjike të BRDN, dy aktivitetet aktuale për rritjen e vizibilitetit të BRDN ishin promovuar” e



para ishte përfundimi i ueb faqes së BRDN dhe e dyta ishte përgatitja e broshurës së BRDN.

Projekti “Mbështetje të Rrjetit për Zhvillim Rural të Ballkanit – BRDN si platformë rajonale për bashkëpunim të rrjeteve rurale të Ballkanit Perëndimor” është mbështetur nga We Effect dhe zbatuar nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë. Projekti ka ndërmarrë veprime për ngritjen e kapacitetit të BRDN duke filluar me përgatitjen e dokumentit strategjik të BRDN si program themelor i dokumentuar për punë.



Fryte të punës së Shoqatës së Artizanëve ARTI KRAFT

Periudhën prej korrikut – dhjetor 2017 ZUR "ARTI KRAFT" ka shënuar me realizimin e aktiviteteve në vijim:

- Ekspozitë të artizaneve të anëtarëve të ZUR Arti Kraft në kuadër të Etno Ditëve në Pehçevë, ngjarje tradicionale të organizuar me rastin e festës fetare pavlovdën (korrik 2017).
- Pjesëmarrje në Manifestimin "Maleshevi në Pëllëmbë" në Berovë (gusht 2017).
- Zbatimi i 2 projekteve të mbështetur nga qyteti i Shkupit:
 - "Zhvillimi i sipërmarrjes artizane dhe vetëpunësimit" (korrik-shtator 2017) në Shkup;
 - Shfaqje e veshjeve popullore të rajonit të Shkupit me titull: "Të ruajmë paurinë tonë kombëtare" me rastin e shënimit të Ditës së pavarësisë së Maqedonisë, 8 shtatori.
- Pjesëmarrje aktive të ngjarjes tradicionale të organizuar me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale. Këtë vit ngjarja ishte organizuar në Resnjë dhe Oteshevë më 17.10.2017 në bashkëpunim me Rrjetin për Zhvillim Rural të RM-së dhe Federatës së Fermerëve të RM-së.
- Më 13 nëntor – Dita e Çlirimit të Qytetit të Shkupit, ZUR Arti Kraft ka zhvilluar manifestimin "Pazar Vjeshtor i Artizaneve Vendore – KOLAZHI I ARTIZANEVE 2017" nën patronazhin e kryetarit të komunës së Butelit, z. Velimir Smilevski dhe në bashkëpunim me NU Qendra Konservatore Shkup. Përveç anëtarëve të ZUR Arti Kraft në ngjarjen kanë marrë



pjesë edhe mysafirë nga Graçanica e Kosovës – Kosovë, Turqi, Serbi dhe Ukrainë.

- Më 1 dhjetor 2017, në Probishtip ishte organizuar festivali i pestë me rend i artit, artizan, dizajn dhe mode, ku anëtarët e shoqatës Arti Kraft kanë promovuar



produktet e tyre. Ngjarja ishte pasuruar me një shfaqje të modës së organizuar nga Mitrovska Gordana Beba, kryetare e shoqatës Arti Kraft.

- Përfaqësues të Arti Kraft kanë marrë pjesë në shumë manifestime ndërkombëtare të artizaneve dhe kanë prezantuar në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë.
- Gjatë verës ZUR Arti Kraft ka organizuar shumë punëtori në Shkup, për përpunimin e suverinëve dhe gjërave me përdorimin e motiveve folklorike, ndërsa në nëntor 2017 ka zhvilluar dy trajnime për zhvillim të sipërmarrjes.





Ngjarje në f. Slloeshticë të organizuar në mënyrë tradicionale nga „Art Point - Gumno“

1. Rezidenca artistike “Art Point – Gumno 2017” (10 – 30 korrik 2017)

E vetmja sipas konceptit jo vetëm në Maqedoni, por edhe në rajonin më të gjerë – Rezidenca Ndërkombëtare Artistike që Qendra Ndërkombëtare për Art dhe Zhvillim të Qëndrueshëm “Art Point – Gumno” në mënyrë tradicionale zhvillon në vazhdimësi prej 14 vjeç, u mbajt në korrik.

Këtë vit, kuriozitet ishte fakti që “Art Point – Gumno” vendosi të ftojë dy çifte artistike që kanë festuar 3 vjetorin e jetës dhe krijimit të përbashkët: Mejsi Largado Rotman dhe Kristijan Rotman nga Berlini (Mejsi ka origjinën nga Mindor, Filipine) Gjermani dhe Eva Majer dhe Aron Majorosh nga Budapesti, Hungari.

Bëhet fjalë për artistë me shtrirje të shkëlqyeshme krijuese, të njohur dhe të çmuar jo vetëm në vendet e tyre por edhe në përmasa ndërkombëtare.

Në mënyrë tradicionale, edhe këtë vit ishte ftuar fotografi maqedonas **Sasho N. Alushevski** të jetë i ftuari special i rezidencës dhe të bëjë portrete të artistëve.

Gjatë kohës në rezidencë, artistët kanë pasur mundësi të njoftohen me veçoritë kulturore-historike dhe natyrore të rajonit, në frymën e mikpritjes së banorëve lokal, kuzhinës tradicionale maqedonase etj.

Ishin realizuar vizita të vendeve të rëndësishme kulturore-historike dhe natyrore të rajonit (Manastir, Krushevë, Strugë; Mariosë, Manastirin Shën Nikolla Topliçki, bibliotekën ALBI në v. Virovë) si dhe vizita të fshatrave dhe “fshatarëve të fundit” të rajonit të Dmir Hisarit të epërm: Mrenoga, Virovo, Babino, Zhvan, etj.

Gjithashtu, Mejsi Largado Rotman ka zhvilluar një punëtori kreative-edukativ me fëmijët e fshatit dhe vullnetarë të APG në temën “Filipinet dhe Maqedonia – çfarë është ajo që na lidh”.

Në kuadër të rezidencës artistike, më 22 korrik u zhvillua **STUDIO E HAPUR**, ngjarje që në mënyrë tradicionale “Art Point – Gumno” e organizon në gjysmën e dytë të qëndrimit të artistëve, me qëllim që publiku të njoftohet me ata dhe të shohë krijimet e tyre. Përveç ekspozitës së veprave të tyre, ishin ekspozuar edhe krijimet e fëmijëve nga punëtorja edukative-kreative. Përveç kësaj, artistët kanë përgatitur edhe befasi “të shijshme” për vizitorët – i kanë qerosur me specialitete tradicionale kuzhine nga vendet që përfaqësojnë.

Në mënyrë ekskluzive, për herë të parë këtë vit, ngjarja ishte “përmirësuar” edhe me pjesëmarrjen e organizatorëve dhe të ftuarit e manifestimit “Nata e 29-të e Poezisë në Velestovë”! Poetët bullgar Vladimir Leçev, Aksinija Mihajlova, Roman Kisjov dhe Poli Mukanova si dhe poeti mongol Letiv Mandag Jançivin u prezantuan para të pranishmëve me lexime poetike. Kjo përvojë pozitive ka motivuar dy organizatat - “Art Point – Gumno” dhe “Nata e Poez-





isë në Velestovë” të mendojnë për vazhdim të bashkëpunimit dhe krijimit të shumë projekteve të përbashkëta në të ardhmen. Aktiviteti është pjesërisht i mbështetur nga Ministria e Kulturës së RM-së.

2. FESTIMI I PIRJEIT I 11-TË (28 gusht 2017)

“**SLLOESHTICA – EMËR PËR NJË BOTË**” është titulli i manifestimit që akademiku Vllada Uroshevic ka shkruar për edicionin e 11-të me rend të pjesëmarrjes për bardin e letërsisë maqedonase Petre M. Andreevski dhe shekullimi i popullit maqedonas. Gjatë manifestimit të këtij viti theks ishte promovimi i edicionit gjerman i romanit “PIREJ – QUECKE”, i shtypur nga ana e shtëpisë së njohur botuese GUGGOLZ VERLAG nga Berlioni. Përkthyesi, Benxhamin Langer, me dedikim të shkëlqyeshëm ka arritur të transmetojë autenticitetin dhe fuqinë e fjalës së Andreevski tek lexuesit gjerman (interesante që në përkthimin e romanit, në mënyrë aktive ishin kyçur jo vetëm familja më e ngushtë e Petre M. Andreevski, por edhe banorët e Silloshticës, ndërsa për aktivitetin e përkthimit, në tetor të këtij viti, në festimin e jubileut 50 vite MANU, Langer morri çmimin prestigjioz – medaljen “Bllazhe Koneski”)

Tema “PIREJ” ishte pasuruar edhe me shfaqjen e aktorëve të monodramës “Velika” nga ekipi i vendosur artistik nga teatri kombëtar i Manastirit Katerina Anevaska – Drangovskam ndërsa gjithë ngjarja ishte plotësuar me muzikë nga zëri i shkëlqyeshëm i kavallit dhe fyellit të artistit maqedonas Goce Dimovski (anëtari i etno grupit “Sintezis”).

Përveç ekspozitës tradicionale të veprave artistike të rezidencës së “Art Point – Gumno”, në mes të fshatit ishte vendosur edhe projekti “A të kujtohet?” – ekspozitë e fotografive të ricikluar dhe pamjeve fotografive, të aktorëve Natasha Petroviq dhe Sllagjana Bujosheviq, dhe artistes Voskeresija Andreevska.

Në mënyrë tradicionale, manifestimi ishte pjesërisht i përkrahur nga Ministria e Kulturës së RM-së dhe nga kryetari (tani ish kryetari) i komunës Demir Hisar, z. Ljupço Bllazhevski.

3. “Art Point – Gumno”

vazhdon me realizimin e projektit të fushës së industrive kreative “**Aroma e ëndrrës**” që ka për qëllim mobilizimin e popullatës së aftë për punë rurale për aktivitete të reja jo vetëm por ekonominë, por edhe për mjedisin jetësor. Për më tepër, lexoni në: <https://www.facebook.com/mirisotnasonot/>

E-mail: artpoint@mk ; www.artpoint-gumno.org.mk





Aktivitetet e FLORIT - Gjevgjeli në fushën e efikasitetit energjetik



Në periudhën prej korrik deri në dhjetor FLORIT – Gjevgjeli ka organizuar dhe ka marrë pjesë në shumë ngjarje të ndryshme.

Fondacioni për zhvillim lokal dhe zhvillim i teknologjive informatike – Gjevgjeli në partneritet me Lidhjen e Prodhuesve të Energjisë Ekologjike – BG nga Bllagoevgrad, Bullgari, me mbështetjen financiare të BE-së me anë të Interreg – IPA programi për bashkëpunim ndërkufitar – Bullgari – Maqedoni CCI2014TC16I5CB006, kanë zbatuar projektin “Promovim i prodhimit të energjisë nga burime të ripërtëritë të energjisë (EnerGAIN)”.

Projekti “EnerGAIN” ka për qëllim të mbështet formimin e një qasje të integruar në fushën ndërkufitare në pjesën e prodhimit të decentralizuar të energjisë nga burimet e ripërtëritë dhe prezantimin e zgjidhjeve për efikasitet energjetik. Realizimi i projektit i stimulon bizne-

set lokale dhe kontribuon për optimizim të shpenzimit të përgjithshëm të energjisë dhe shpenzimeve. Një prej qëllimeve themelore është përmirësimi i vetëdijes dhe rritje të interesit të grupit synues dhe aktorëve të rajonit ndërkufitar për zgjidhje të decentralizuar energjetike dhe shfrytëzim të potencialit të burimeve të ripërtëritë të energjisë dhe përfitimet kryesore: ekologjike; ekonomike (shpenzime të zvogëluara dhe pavarësi energjetike); efikasitet (cilësi të energjisë elektrike dhe qëndrueshmëri); ruajtje të resurseve (përdorimit të BRE); siguri dhe qetësi. Në këtë drejtim, projekti promovon konceptin, teknologjitë kryesore dhe përfitimet për objekte individuale banesore, objekte afariste dhe publike (komuna, sektori arsimor, institucionet, etj.).

Në kuadër të projektit me sukses ishin realizuar të gjitha aktivitetet e parashikuara.

Gjithsej 6 punëtorë nga fushata në temën “Çati diellore” ishin zbatuar në Bullgari dhe Maqedoni. Në Gjevgjeli ishin realizuar 3 punëtorë që kanë shkaktuar interes tek pjesëmarrësit, qytetarët e komunës së Gjevgjelisë dhe rrethinës.

Trajnime të përbashkëta të specializuara për BRE për teknik dhe inxhinierë - ngritja e kapaciteteve, shkëmbim i përvojave dhe njohuri në pjesën e programit për profesionistë dhe ekspertë në fushën e BRE dhe EE, ishin të mbështetur në Bllagoevgrad dhe Strumicë. Në trajnimet kanë marrë pjesë 10 teknik dhe inxhinierë nga Maqedonia dhe 10 nga Bullgaria që punojnë në fushën e energjisë së ripërtëritë dhe efikasitet energjetik.

Në gjitha ngjarjet, ekspertët e fushës së BRE dhe EE kanë shkëmbyer përvojën shumëvjeçare dhe ju kanë ndihmuar pjesëmarrësve të rrisin njohurinë dhe shkathtësitë dhe gjithashtu të nxisin shkëm-





bimin e përvojave, njohurisë dhe shkëmbimit të praktikave në fushën e burimeve të ripërtëritë të energjisë dhe prezantim të përfitimeve përkatëse.

“Udhëzuesi diellor për investime” i synuar për tre lloje të përdoruesve – amvisëri private, NVM dhe ente publike ishte hartuar në tre gjuhë dhe i njëjti në periudhën vijuese do të shpërndahet dhe do të jetë i gatshëm për gjithë të interesuarit në version të shtypur.

Energji të ripërtëritë dhe efikasiteti energjetik, energjia diellore, biomasë, energjia gjeotermale, en-

ergjia ujore, janë titujt e filmave të shkurt edukativ që janë vendosur në ueb portalin <http://energain.eu/mk/> në të cilën gjenden gjitha informacionet lidhur me projektin “EnerGAIN”. Portali ju siguron gjithë përdoruesve potencial informacione dhe këshilla përkatëse për zgjidhje bashkëkohore për shtëpi me efikasitet energjetik dhe ekologjik, biznes ose institucion tjetër, si dhe e-mësim me anë të programit on-line për trajnim.

Ishin krijuar modele të shtëpive demonstrative për pavarësi energjetike si në Bullgari ashtu edhe në

Maqedoni. Me modelet e krijuar të modeleve të pavarura energjetike të shtëpive të rinjtë nga rajoni i Bllagoevgrad dhe Gjevgjelia kanë pasur mundësi të njoftohen dhe të fitojnë njohuri themelore nga fusha e BRE dhe EE.

Modelet e shtëpive të pavarura energjetike ishin prezantuar edhe në konferencën përfundimtare që ka shënuar edhe përfundimin e projektit, por jo edhe përfundimin e ndjekjes së potencialit për zhvillim të teknologjive të reja dhe shfrytëzimi i energjisë së gjelbër nga burime të ripërtëritë.





Koalicioni Rural

1. Në periudhën prej qershor-gusht 2017, Koalicioni Rural në kuadër të projektit ka zhvilluar një hulumtim të gjerë në teren në temën: Gjendja me bashkimin në shoqëri në sektorin bujqësor. Në kuadër të hulumtimit ishin përfshirë 800 të anketuar/fermerë, anëtarë të shoqatave bujqësore nga gjitha 8 rajoneve të planifikimit në Maqedoni, ndërsa qëllimi ishte të përcaktohen qëndrimet e fermerëve në lidhje me bashkimin në sektorin bujqësor dhe sa ajo kontribuon (ose jo) për kyçjen e tyre aktive dhe ndikon në proceset konsultuese të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit gjatë krijimit të politikave dhe miratimit të dokumenteve publike dhe vendime. Rezultatet e analizës mund të gjenden në lidhjen vijuese:

<http://rural.mk/%D0%B8%D0%B7%D0%B3%D0%BE%D1%82%D0%B2%D0%B5%D0%BD%D0%B0-%D0%B0%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D1%81%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%BE-D1%98%D0%B1%D0%B8%D1%82%D0%B5-D1%81%D0%BE-%D0%B7%D0%B4/>

përveç kësaj, pas përpilimit të analizës dhe përmbledhjes së rezultateve, muajt e shtatorit dhe tetorit 2017 i kanë shënuar 8 debate me grupe synimi fermerë dhe me qëllim të transmetohen përfundimet e arritura në një masë sa më të madhe "kritike" të fermerëve, por edhe të zhvillohet debat në lidhje me gjendjet e bashkimit në sektorin bujqësor si dhe përmirësimi dhe avancimi i tyre. Hulumtimi dhe analiza ishin realizuar në kuadër të projektit "**Përforcimi i kapaciteteve të shoqatave për pjesëmarrje participative në procesin e miratimit të dokumenteve publike dhe politikave në bujqësi dhe zhvillim rural**" financiarisht i mbështetur në kuadër të programit Civica Mobilitas.

2. Më 19 shtator 2017 në Klubin e Gazetarëve, Koalicioni Rural ka zhvilluar një konferencë për shtyp në temën: "Fermerët nuk janë kyçur në krijimin e politikave!". Në konferencën për shtyp ishte theksuar që **mungesa e besimit në institucionet, mungesa e proceseve transparente të kyçjes së fermerëve në proceset e miratimit të dokumenteve publike dhe politikave në bujqësi dhe zhvillim rural** imponohet si një prej problemeve kryesore ose sfidave me të cilët përballohen fermerët e vendit. **Vetëm 3 për qind të fermerëve e njohin Ligjin**

për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, që është baza për rregullimin e punës së tyre, dhe **madje 64 për qind kanë marrë përgjigje të kërkesave të tyre nga institucionet përgjegjëse për zhvillim të bujqësisë, në afat më të gjatë se 15 ditë**. Nga ana tjetër, asnjë fermer nuk është ankuar për këtë sjellje të institucioneve, madje fermerët nuk dinë çfarë të bëhet kur efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimeve publike është bërë në minimum. Kur bëhet fjalë për subvencionet, madje **60 për qind të fermerëve konsiderojnë që duhet të ndryshohet mënyra e shpërndarjes së tyre edhe atë duke prezantuar komponentin zhvillimor**, megjithatë fermerët nuk janë të informuar si dhe nëse munden të ndikojnë mbi politikën e subvencionimit, me çfarë paraqitet nevoja e përforcimit të vetëdijes tek fermerët për nevojën e një Ministrie të hapur dhe transparente. Konferenca për shtyp ishte një hyrje të fillimit të monitorimit të punës së Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit të cilin Koalicioni Rural do të zbatojë në periudhën korrik 2017– janar 2018, në kuadër të projektit *Llogaridhënie për punën me të hollat e qytetarëve – reforma të administratës publike që vështirë arrihet*.

3. Koalicioni Rural ishte gjithashtu edhe pjesë e **Javës së organizatave qytetare** që është zhvilluar në periudhën 11-15 shtator 2017 në organizim të USAID Civic Engagement Project në të cilën 20 organizata qytetare me anë të ngjarjeve publike kanë pasur mundësi të prezantojnë aktivitetet e tyre para grupit synues. Koalicioni Rural përveç prezantimit të qëllimeve, fushave dhe aktiviteteve të veprimit para fermerëve dhe medieve lokale në Likovë, ka hapur edhe temë për diskutim – Si





fermerët të kyçen në proceset e krijimit dhe zbatimit të politikave kombëtare dhe lokale që përfshijnë interesat e tyre.

4. Koalicioni Rural në mënyrë aktive u kyç edhe në fushatën **16 ditë aktivizëm në luftën kundër dhunës familjare dhe të bazuar në gjini**, gjatë së cilës më 4 dhjetor në Kumanovë ka zhvilluar një punëtorë inspektimi në temë: "Veprim i koordinuar i institucioneve dhe qytetarëve për të vendosur fund dhunës mbi gratë dhe vajzat". Në punëtorinë e inspektimit ishin të pranishëm përfaqësues të gjithë institucioneve që punojnë në këtë problem edhe atë: Qendra për Punë Sociale, përfaqësues të Këshillit dhe komuna e Kumanovës, MBP, mësimdhënës dhe nxënës së shkollave të mesme të komunës, fermerë dhe gra rurale, ekspertë juridik si dhe përfaqësues të institucioneve shëndetësore.
5. Gjatë muajit dhjetor gjithashtu Koalicioni Rural ka zhvilluar **dy konferenca për shtyp dhe debate lokale me fermerë në temën: "Fermerët i japin dysh ministrisë kompetente!"**. Konferencat për shtyp ishin mbajtur në Kumanovë dhe Prilep ku fermerët lokal dhe mediet kanë pasur mundësi të dëgjojnë rezultatet e hulumtimit në teren që Koalicioni Rural ka zhvilluar me 400 fermerë për të hulumtuar qëndrimet, perceptimet, mendimet dhe përvojat e tyre me kyçjen dhe anëtarësimin në trupat e punës së Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë





dhe Ekonomisë së Ujit, por edhe të transmetojë përfundimet dhe qëndrimet nga intervistat e zbatuara me të punësuarit e ministrisë në këtë temë.

6. Koalicioni Rural fitoi **kryetarin e ri**. Këtë vit organizata e përmbyll me emërimin e Menduh Nuhija për kryetar, i cili do të përfaqësojë interesat e fermerëve, shoqatave partnere të Koalicionit gjatë periudhës vijuese 4 vjeçare. Menduh Nuhija ishte i zgjedhur me votë njëzëri për kryetar të organizatës në Kuvendin e zhvilluar më 12 dhjetor këtë vit, dhe vije si fermer, blegtor që vepron në sektorin më gjatë se 30 vite, aktiv si në prodhimtari, ashtu edhe në proceset e krijimit dhe zbatimit të politikave bujqësore në Maqedoni me anë të anëtarësimit në shumë grupe të punës dhe grupe të trupave kombëtare dhe lokale shtetërore dhe institucione, forume, grupe, këshilla, etj.





Ngjarje Velo Rodeo

Si pjesë e projektit “Edukimi për çiklizëm me anë të teorisë dhe praktikës”, një projekt që ka për qëllim promovimin e biçikletës si mjet ekologjik të transportit, por edhe për çlodhje, shoqata e qytetarëve Eko Logjik ka organizuar ngjarjen për biçikleta “Velo Rodeo”. Ngjarja ishte realizuar në bashkëpunim me SHFK Rade Kratovçe nga Koçani dhe klubin e shkollës “Trkallo”, si dhe me iniciativën qytetare “Lëviz me Gishtë”. Ajo u zhvillua më 29.09.2017 në Koçan dhe pjesëmarrës kanë qenë nxënës të klasave të 5-të, 6-të dhe 7-të të 20 shkollave fillore me flamur të gjelbër nga rajoni i Bregallnicës.

Më 23.10.2017 në Bogomillë, shoqata e qytetarëve Eko Logjik ka organizuar ngjarjen e 6-të me biçikletë “Velo Rodeo”. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë nxënësit e shkollës fillore “Petar Pop Arsov” – Bogomillë të moshave prej 7 deri 12 vjeç.

Garat përbehen nga shtigje që janë vendosur rreth njëzet ushtrime të ndër-lidhura me biçikletë dhe kanë për qëllim të përmirësojnë shkathtësitë tek fëmijët dhe njëherë të rrisin vetëdijen për përdorimin e biçikletës si mjet i përditshëm i transportit.

Lidhje: <http://www.ecologic.mk/Default.aspx#p=30134>

Lidhje: <http://www.ecologic.mk/Default.aspx#p=30144>

Punëtori për sipërmarrje sociale

Si pjesë e projektit “Sipërmarrje Sociale – Kënaqësia Personale dhe Ndryshimi Shoqëror”, i mbështetur nga qyteti i Shkupit, Eko Logjik ka zhvilluar tre punëtori në shkollat e mesme SEPUGS “Vasil Antevski Dren”, SETU “Mihallo Pupin” dhe SUGS “Georgi Dimitrov” që gjenden në territorin e qytetit të Shkupit. Punëtoritë ishin zhvilluar në periudhën prej 10 tetor deri më 20 dhjetor 2017.

Qëllimi i punëtorive është ngritja e nivelit të informimit dhe vetëdijes për sipërmarrjen sociale dhe mundësitë që ofron për përmirësimin dhe/ose zgjidhjen e problemeve shoqërore dhe nxitjen e ndryshimeve shoqërore dhe zvogëlim të papunësisë tek të rinjtë.

Lidhje: <http://www.ecologic.mk/Default.aspx#p=30137>

<http://www.ecologic.mk/Default.aspx#p=30150>





Qendra Edukative “Zhabec”

“ZHABEC” paraqet qendrën e parë dhe të vetme edukative për fëmijë në Republikën e Maqedonisë që promovon temat e ekologjisë dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor. Këto tema shërbejnë si bazë me anë të cilës fëmijët mësojnë për tema dhe situata të ndryshme dhe reale dhe bashkëkohore në të cilat ata janë aktorët kryesorë prej të cilëve do të del ndryshimi pozitiv, në çdo fushë të jetës së përditshme.

Qendra Edukative për Fëmijë “Zhabec” shërben për gjithë fëmijët e vegjël dhe të mëdhenj, të moshave prej 6 deri më 12 vjeç.

Qendra Edukative për Fëmijë “Zhabec” dallohet prej qendrave tjera edukative që në punën e saj parashikon përmirësimin dhe avancimin e sfidave dhe problemeve të ndryshme sociale, me anë të:

- Mësimi të temave që nuk gjenden në mësimin e rregullt të shkollave dhe janë me rëndësi të madhe për zhvillim moral, sociale, fizik dhe ekologjik të fëmijëve;
- 33 % të përfitimit nga qendra do të orientohet për aktivitete edukative të synuar për fëmijë të kategorive të cenuara (fëmijë pa prindër, fëmijë të prindërve të vetëm, fëmijë nga familje që gjenden në situatë të vështirë ekonomike, etj.).

Lidhje: <https://www.facebook.com/%D0%94%D0%B5%D1%82%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%B5%D0%B4%D1%83%D0%BA%D0%B0%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%B5%D0%BD-%D1%86%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80-%D0%96%D0%90%D0%91%D0%95%D0%A6-1014771281995944/>





Vizitë të panairove ndërkombëtar

Shoqata “Ujë i pastër – ushqim i shëndetshëm” punon në ruajtjen e mjedisit jetësor në Dibër dhe rajonin e Dibrës dhe rrethinën me anë të ruajtjes së bukurive natyrore të rrethit, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe kujdes për okupacionet tradicionale dhe shprehi prodhuese të popullatës nga rajoni. Shoqata kontribuon që të zhvillohet turizmi rural me anë të promovimit të bukurive natyrore të rrethinës së Dibrës, si dhe ruajtjen dhe avancimin e delëtarisë si veprimtari e dalluar për rajonin.

Përfaqësues të shoqatës “Ujë i pastër – ushqim i shëndetshëm” kanë vizituar shumë panaire ndërkombëtare për bujqësi, në Bullgari, Serbi, Turqi dhe Hungari me qëllim të akumulimit më tepër njohuri për teknologjitë më të reja dhe mekanizimi që zbatohen në bujqësi dhe të njëjtat të ndajnë me fermerët e rajonit të Dibrës. Ata kanë realizuar takime të suksesshme me shumë prodhues dhe kompani të disa vendeve të Azisë dhe Turqisë, duke hapur mundësi për një bashkëpunim të ardhshëm dhe shembim të përvojave.





Promovim i traditës së Krushevës

Organizata e grave "Cvet" nga Krusheva në mënyrë aktive punon në promovimin dhe ruajtjen e kulturës dhe traditës së Krushevës, në këtë mënyrë duke nxitur zhvillimin e turizmit në këtë vend. Në bashkëpunim me tour-operator lokal, "Cvet" ka organizuar një vizitë të Krushevës për një grup të grave, turistë nga Australia, që kanë pasur mundësi të shohin arkitekturën e mrekullueshme të Krushevës dhe natyrës, si dhe të njoftohen me historinë me anë të muzeve dhe përmendoreve. Vizitorët ishin veçanërisht të mahnitur nga dy punëtoritë e organizuar nga ana e organizatës "Cvet", ku kanë mësuar për të përgatitur pite tradicionale dhe ishin të njoftuar me qepjen tradicionale nga viset e Krushevës.

Për kontributin personal në afirmimin e kulturës dhe traditës së Krushevës, organizatës "Cvet" i ishte ndarë çmimi "Çmimi 8 Shtatori" nga fusha e kulturës dhe promovimit të vlerave tradicionale të trashëgimisë kulturore të Krushevës, nga ana e Këshillit të Komunës. Gjatë 6 muajve të fundit, organizata morri edhe një çmim, gjegjësisht çmimin kombëtar për vullnetarizëm nga Këshilli Kombëtar i Republikës së Maqedonisë.





Shënohet dita ndërkombëtare e gruas rurale

Federata e Fermerëve e RM-së dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së, në mënyrë tradicionale edhe këtë vit ka shënuar Ditën Ndërkombëtare e Gruas Rurale – 15 tetori.

Programi i këtij viti ka filluar në Resnjë, më 17 tetor, me marsh që ka pasur për qëllim të dërgojë mesazhe tek publiku më i gjerë për nevojën e gruas rurale që të përforcohet në kuptimin ekonomik, përfshirje më të madhe në krijimin e politikave bujqësore, luftë të përbashkët kundër barrierave tradicionale që bëjnë më tepër problem në pjesën e edukimit dhe zhvillimit ekonomik, siç është pronësia e tokave, pronave, etj. Më vonë, në hotelin Lake View në Oteshevë, ishte organizuar një festim solemn që ka pasur karakter humanitar. Mjetet e mbledhura ishin dhënë një familjeje të varfur në Prespë, që ka identifikuar shoqata “Bllagoj Kotlarovski”.

Në Manifestimin që ka pasur për qëllim të theksojë rolin e gruas në bujqësi dhe zhvillimin rural kanë marrë pjesë gra rurale nga gjithë anët e Maqedonisë, por edhe përfaqësues të institucioneve shkencore, arsimore dhe tjera që bashkëpunojnë me popullatën rurale.

